

**Begzad BALIU**  
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit  
Prishtinë

## **PROFESOR NEXHIP MËRKURI: GJUHËTARI DHE EDUKATORI**

Punim studimor

**Përmbajtje e shkurtër:** Në historinë e studimeve të gjuhësisë shqiptare është krijuar një brez studiuesish me emrin e të cilëve janë të lidhura ngushtë dy rrafshet të zhvillimeve akademike dhe shkencore: ajo e mësimdhënies dhe ajo e kërkimeve shkencore. Nëse pararendësit e tyre të dijes albanologjike vinin kryesisht nga tryezat shkencore dhe institutet kërkimore, ky brez pothuajse përgjithësisht vjen pas një përvoje të gjatë në institucionet arsimore të provincave ku ishin dërguar për të kryer misionin e tyre në shërbim të edukimit popullor. Nuk është e rastit që ky brez studiuesish, pothuajse pa përjashtim, i vazhdon shkallët e ngritjes së tij deri në majat e institucioneve akademike, ndërsa në të njëjtën kohë merret intensivisht me kërkimet në teren, diskutimet shkencore në konferencat akademike dhe me sintezat shkencore. Nuk është gjithashtu e rastit që ky brez, po ashtu, ka përgatitur një rreth më të gjerë studiuesve të rinj, duke qenë përkrah tij nga fillimet deri në kurorëzimet e para shkencore.

**Fjalët çelësa:** Nexhip Mërkuri, mësimdhënia, gjuha, etnolinguistika, onomastika.

### **Në vend të biografisë**

Profesor Nexhip Mërkuri është njëri prej studiuesve, i cili me tekstet didaktike shkollore: *Probleme të mësimdhënies* (2000); *Modele të suksesshme mësimdhënieje* (2004); *Ndërveprimi në klasë* (2003);

*Teste në lëndën e gjuhës shqipe 2* (2002); *Teste në lëndën e gjuhës shqipe 3* (2002); *Teste në lëndën e gjuhës shqipe 4* (2002); *Teste në lëndën e gjuhës shqipe 2* (2005); *Teste, fletë pune në lëndën e gjuhës amtare 2* (2005); *Teste, fletë pune në lëndën e gjuhës amtare 3* (2006); *Teste, fletë pune për gjuhën shqipe 3* (2008); *Teste, fletë pune për gjuhën shqipe 4* (2007); *Teste, fletë pune për gjuhën shqipe 5* (2008); me tekstet universitare: *Gjuhë shqipe 1* (Modul), (2018); *Gjuhë shqipe 2* (Modul), (2018); *Formim gjuhësor* (2018), si dhe me përmbledhjet shkencore e monografite e tij<sup>1</sup> ka sjellë rezultate të rëndësishme në jetën tonë shkencore dhe akademike në fushë të gjuhësisë.

Në një kohë që shumë nga gjuhëtarët shqiptarë me përvojë të gjatë kërkimi e kurorëzimi të veprimtarisë shkencore, po i përmbyllin sintezat e tyre shkencore me thërrmija përsiatjesh shkencore apo përmbledhje të teksteve të periudhave të hershme, profesor Nexhip Mërkuri, së fundi po i kurorëzon arritjet e tij shkencore me sinteza të rëndësishme për gjuhësinë shqiptare dhe madje ballkanike. Të kësaj natyre janë edhe tekstet shkollore e universitare për mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe, me interes për didaktikën e mësimnxënies në shkollat shqipe, me të cilat ai ka sjellë përvojën e tij prej disa dekadash në arsimin fillestar dhe në atë universitar.

Nexhip Mërkuri (Këlcyrë, 4 shkurt 1955), mësimet e para i ka bërë në vendlindje dhe ato universitare në Tiranë, ndërsa kontributin e tij prej mësimdhëniesi, gjuhëtari e drejtuesi në fushë të mësimdhënies e ka dhënë në vendlindje, qytetin e Përmetit, Institutin e Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani”, në Elbasan dhe në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”.

I specializuar për Gjuhësi të përgjithshme, Leksikologji të përgjithshme, Gjuhë frënge dhe ruse në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Tiranë; i specializuar, me grada shkencore e thirrje universitare për gjuhë shqipe në qendrat më të larta akademike e

---

<sup>1</sup> Nexhip Mërkuri, *Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë*, Vlorë, 2003, f.163; *E folmja e Përmetit, fjalor krahinor, fjalori i bimësisë së trashëguar*, Vlorë, 2009, f. 460; *Gjuhësi e krahasuar*, Vlorë, 2018, f. 494; *Onomastikë krahasuese*, Vlorë, 2022, f. 464; *Fjalori i onomastik i Përmetit*, Tiranë, 2024.

universitare të Tiranës, si: Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Tiranë (1996 – 2004); i doktoruar në gjuhësi (1996); Profesor i asociuar (2004); Profesor i rregullt (2011), profesor Nexhip Mërkuri ndërtoi një karrierë të rregullt e të plotë të arritjeve të tij universitare, madje si rrallë të tjerë, që nga nivelet e ulëta të mësimdhënies e deri te shkallët më të larta universitare e pasuniversitare.

Le të thuhet këtu në hyrje se pjesë e angazhimeve të tij qytetare, intelektuale, pedagogjike, kulturore e shkencore janë edhe projektet: 1. *Kualifikim për metodat e reja në lëndët gjuhë shqipe dhe lexim letrar për mësuesit pa arsimin përkatës* (Tiranë, 1996), të cilin e hartoi dhe drejtoi me shumë sukses; 2. Projekti *Trashëgimia kulturore e Lumit të Vlorës* (2005-2006), në të cilin ishte bashkëhartues; projekti ndërkombëtar *Interventi di informazione dell'immagine dell'Albania* (2006-2008), në të cilin ishte bashkëdrejtues, si dhe projekti nacional i vlerësuar për hartimin dhe angazhimin e suksesshëm *Fjala krahinore dhe prirja në gjuhën standarde*, realizuar brenda Universitetit "Ismail Qemali" më 2009.

## **1. Fillimet kërkimore të Profesor Nexhip Mërkurit**

### **1.1. Përkushtimi ndaj didaktikës së tekstit dhe të mësimdhënies**

Nëse do të bënim një tipologji të interesimeve të profesor Nexhip Mërkurit në fushë të mësimdhënies dhe didaktikës së kërkimit e të realizimit të teksteve të mësimdhënies, nuk do ta kishim vështirë t'i theksonim edhe përbërësit kryesorë të këtij angazhimi: a. kërkimet bashkëkohore-teorike të terminologjisë së didaktikës në një rrafsh të ri e modern të kohës; b. kërkime të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga shkollat fillore te përvoja universitare, nga tekstet themelore të gjuhës e letërsisë te fletorja e punës, modulet dhe libri i mësuesit; c. kërkime të shqipes së zbatuar në tekstet e gjuhës dhe letërsisë nga tekstet elementare te analizat shkencore. Të kësaj natyre janë diskutimet në tryezat shkolllore, artikuj profesionalë, studimet

për konferencat shkencore, sintezat e botuara në revistat profesionale etj. Fjala është për tekstet rreth terminologjisë së gjuhës në kurrikulën e edukimit parashkollor, analizën për lexuesin e mesazhit letrar dhe konteksti gjuhësor, për rëndësinë e integritimit ndërlëndor..., për hulumtimin komplementar gjuha dhe leximi, pikat e ndarjes dhe të bashkimit, si dhe kulturën gjuhësore dhe integritimin ndërlëndor, hulumtimet në shkollat elementare probleme të formimit gjuhësor të nxënësve në arsimin tetëvjeçar, dhe degëzimi i objektivit të përgjithshëm në lëndën e leximit letrar. Një seri tekstesh me interes për të nxënit të gjuhës dhe letërsisë në kontekst të plotësimit të kurrikulës lëndore janë ato me objektiv gjuhën shqipe dhe mësimin e shkrim- leximit apo ato për realizimin e standardeve në lëndën e gjuhës amtare, si dhe ato për kulturën gjuhësore në kontekst të asimilimit të dialektit në trevat buzë Adriatikut, po dhe ato për trashëgiminë gjuhësore në kontekst të ruajtjes së regjistrave leksikorë.

Brenda domenit të kërkimeve didaktike të analizave të tij në fushë të didaktikës hyjnë në mënyrë të veçantë artikujt për metodën e kërkimit alternativ në tekstet universitare, si kusht i zhvillimit të mendimit kritik dhe intelektual e didaktik, apo edhe ato për pikëpamjet e pedagogëve të shquar të kohës për mësimdhënien sikur janë Akademik Ethem Likaj, Badhosh Gaçe, Qemal Haxhihasani etj. Po të kësaj fushe janë artikujt studimor për raportet ndërmjet kurrikulave dhe shqipes standarde: vështrim për realizimin e standardeve në lëndën e gjuhë shqipe, kërkime në të lexuarit fillestar të nxënësve, dukuritë mbisegmentore dhe tekstet e gjuhës shqipe I-IX, të folurit dhe tekstet e gjuhës shqipe, teksti universitar dhe metoda e kërkimit, alternativë e domosdoshme etj., rezultatet e të cilave janë paraqitur jo vetëm në Universitetin e Vlorës, po edhe në universitetet vendore, rajonale e ndërkombëtare.

Si me tekstet e shkollave parauniversitare, ashtu edhe me ato universitare, profesor Nexhip Mërkuri e ka përplotësuar një mungesë të madhe në jetën tonë shkollore me tekste, module e fletë pune të munguara prej kohësh. Botimet e tij didaktike e kanë lehtësuar punën

tonë në arsimin kombëtar dhe e kanë modernizuar atë me qasje të reja, me metoda dhe madje teknika të reja pune.

### **1.2. Përkushtimi ndaj kërkimeve shkencore në fushë të gjuhësisë**

Fillimet e kërkimeve në fushë të arsimit dhe shkencës së gjuhës në jetën arsimore dhe shkencore të profesor Nexhip Mërkurit janë të lidhura ngushtë me përvojën e pasur arsimore të tij në shkollat e Përmetit dhe me shqyrtimin, analizat e përgatitjen e teksteve shkollore të gjuhës shqipe. Po kështu mund të thuhet edhe për artikujt e parë vlerësues, recensues e shkencor të lidhura ngushtë me Përmetin me rrethinë, por me çështje të përgjithshme e të veçanta të gjuhës, si dhe vlerësime për autorë e vepra të botuara të kohës për gjuhën shqipe dhe gjuhësinë përgjithësisht. Le të theksojmë këtu artikujt apo vlerësimet me interes për emërtimet popullore togfjalëshe të bimësisë, vlerësimin dashamirës për librin e profesor Gjovalin Shkurtaj, “Ta duam dhe ta ruajmë gjuhën tonë të bukur”, për një dorëz shprehjesh popullore nga rrethi i Përmetit, për problemet gjuhësore tek krijuesit vlonjatë të mijëvjeçarit të ri, për përmbledhjen e studimeve emblematike të studiuesve shqiptarë në librin “Himara në shekuj”, për veçoritë estetike të gjuhës së Naim Frashërit, për kulturën gjuhësore dhe purizmin si veçori artistike dhe estetike në veprën e Ali Asllanit, për emërtimet e lashta të bimësisë, për oksimoronin dhe dallesën e përcaktorëve në prozën e Petro Markos, për veprën e gjuhëtarit të shquar Shaban Demirajt mbi Epirin dhe Mesapët, për disa veçori të sociolinguistikës diakronike tek Kanuni i Labërisë, për ndihmesën e profesor Rami Memushajt për çështje të planifikimit gjuhësor dhe të politikave gjuhësore, për ndihmesën e profesor Bardhosh Gaçes, dhe në edukimin e brezave universitar, për ndihmesën mbresëlënëse të profesor Fatmir Agalliut, në jetën tonë shkencore e didaktike, për trashëgiminë e pasur që ka lënë profesori e folkloristi i madh i shekullit XX, Qemal Haxhihasani për të folmet e fshehta të Përmetit, për perspektivën e studimeve dialektore nga

brezi i ri i studiuesve shqiptarë, për kodet e ilirishtes dhe gjuhësinë historiko-krahasuese etj.

## **2. Projektet monografike dhe shkencore**

### **2.1. Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë**

*Vepra Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë 2*, është vepra e parë e kësaj qasjeje në fushë të linguistikës shqiptare në Tiranë. Monografia e profesor Mërkurit, metodologjikisht, qëndron ndërmjet rrafshit dialektor dhe atij sociolinguistik të kërkimit.

Vepra përbëhet nga pesë krerë, të cilëve ju prinë një Parathënie dhe përmbillet nga një sintezë e Përfundimeve dhe Bibliografia. Kapitulli i parë është ndërtuar nga përshkrimi gjeografik, etnografik e gjuhësor i zonës së krahinës së Dishnicës përkatësisht Përmetit, një metodë kjo tipike e botimeve antro-po-gjeografike e shekullit XX. Kërkimi është bërë në të gjitha fshatrat e kësaj zone dhe janë vjelë rreth 3500 njësi leksikore, të mjaftueshme këto për analiza themeltare dhe madje për sinteza e tipologji shumështrësore të karakterit semantik, fjalëformues, frazeologjik e krahasues. Sikur e thekson autori që në Parathënie, kërkimi është bërë sipas Teoremës së emërtimit të Lajbinicit. Nëse në kapitullin e parë studiuesi mbështetet kryesisht në metodën historiko-gjuhësore, një model ky tipik i shkollave gjuhësore të gjysmës së parë të shekullit XX, me shumë ndikim në shkollën shqiptare, në kapitullin e dytë ku trajtohen problemet teorike e praktike të emërtimit të bimëve, autori ynë kalon në teorinë tjetër të gjuhësisë, ku më pak e ku më shumë të strukturalizmit gjuhësor. Njohja e tij e literaturës vendore dhe asaj ndërkombëtare nuk mjafton dhe nuk përjashtohet në të gjitha fazat kërkimore, analitike e sintetike.

Fillimisht ai merret me karakterin shënjes të emërtimit dhe më pastaj me nomenklaturën popullore të emërtimit të bimësisë.

---

<sup>2</sup> Nexhip Mërkuri, *Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë*, Vlorë, 2000, f. 163.

Boshtin e kërkimit, analizës dhe rezultateve të kësaj monografie e përbëjnë tre krerët në vazhdim: Analiza semantike; Analiza strukturore e fjalëformimeve dhe emërtimeve; dhe Frazeologjia. Në kreun për analizën semantike, profesor Mërkuri merret me tre përbërës kryesorë: emërtimet polisemike, sinoniminë dhe antoniminë. Sikur e thekson që në fillim, synim i tij është “të zbulohen aftësitë komunikuese të elementeve të emërtimeve të ndërtuara sipas një tipari që të bie në sy, dy tipareve, shkallëzimi i formimit të emërtimit, shënimi në fillim i llojit të nënlloji, grupimi për motivimin e emërtimit, karakteri i figurshëm i disa emërtimeve: sinonimia, antonimia dhe tek emërtimet togfjalëshorë dhe ata frazeologjikë”. Në kreun për strukturën fjalëformuese të emërtimeve autori merret me emërtimet e prejardhura të kompozitave, emërtimet e formuara me parashtesim, prapashtesim dhe me përbërje, si dhe me emërtimet togfjalëshorë. Synimi i autorit ishte “të analizohet emërtimi edhe nga ana strukturore, specializimi i ndajshesave. Krahasimi me atë të gjuhës shqipe në përgjithësi, krahasimi i bimësisë së egër dhe asaj të kultivuar. Emërtimet togfjalëshorë, radha e vendosjes së përcaktorëve, kur ato janë dy pas gjymtyrës kryesore”.

Në këtë vepër, që mund ta quajmë edhe sprovë për një hyrje bashkëkohore në studimet gjuhësore të fitonimisë së shqipes në institucionet shqiptare, autori arrin deri tek disa përfundime me interes për studimet e kohës. Krahasimi me atë të gjuhës shqipe në përgjithësi, krahasimi i bimësisë së egër dhe asaj të kultivuar. Emërtimet togfjalëshorë, radha e vendosjes së përcaktorëve, kur ato janë dy pas gjymtyrës kryesore”. Në këtë vepër, që mund ta quajmë edhe sprovë për një hyrje bashkëkohore në studimet gjuhësore të fitonimisë së shqipes në institucionet shqiptare, autori arrin deri tek disa përfundime me interes për studimet e kohës. Krahasimi me atë të gjuhës shqipe në përgjithësi, krahasimi i bimësisë së egër dhe asaj të kultivuar. Emërtimet togfjalëshorë, radha e vendosjes së përcaktorëve, kur ato janë dy pas gjymtyrës kryesore”.

Në studimin monografik të tij, profesor Mërkuri, ka konstatuar edhe shumë shembuj, e kjo do të thotë se ka ardhur në përfundimin, sipas të cilit për disa bimë janë zhvilluar edhe kuptime të dyta, të cilat janë rezultat i formave të figurshme të tyre, të krahasueshme edhe me bimë apo objekte të tjera të përafërta. Karakteristike e këtyre emërtimeve është fakti se emërtimet e dyta bëhen kryesisht për emra bimësh me emërtime togfjalëshorë me dy gjymtyrë.

I njohur me pasurinë leksikore, me hulumtimin e motiveve shumështrësore të banorëve të hapësirës etno-gjeografike të Përmetit, si dhe me strukturën morfo-sintaksore të saj, profesor Mërkuri ka konstatuar se korpusi i mbledhur i tij jep shumë mundësi kërkimi, analize, sinteze e tipologjie të grupeve e nëngrupeve të tyre. Ky kërkim, falë hulumtimit të tij, i cili paraqet një trashëgimi me pak mundësi që të hulumtohet sot në rrethana lëvizjesh të shumta të popullsisë, në të ardhmen mund të bëhet objekt studimi nga breza të tjerë studiuesish.

## 2.2. E folmja e Përmetit

Monografia *E folmja e Përmetit, fjalor krahinor, fjalori i bimësisë së trashëguar*<sup>3</sup> është vazhdim i kërkimeve të tij zonën e Përmetit tash në një rrafsh tjetër gjuhësor, nga fusha e leksikografisë në fushë të dialektologjisë.

*E folmja e Përmetit* është parë e ndarë në tri të folme etnografike: E folmja e zonës së Përmetit; E folmja e zonës së Dëshnicës; E folmja e zonës së Dangëllisë. Parë në kontekstin e traditës së studimeve dialektologjike, një përshkrim i tillë do të mjaftonte për krijimin e një pamjeje tipike dialektologjike, por autori këtu nga rrafshi tradicional, kalon te rrafshi sociolinguistik, me analizat që sjell për veçoritë e të folmes së Përmetit te popullsia shkollore, për faktorët që kushtëzojnë sjelljen gjuhësore dhe kulturën gjuhësore, për formimin gjuhësor të nxënësve të arsimit të detyruar

---

<sup>3</sup> Nexhip Mërkuri, *E folmja e Përmetit (fjalor krahinor, fjalori i bimësisë së trashëguar)*, Vlorë, 2009, f. 460.

dhe përmasa e të nxënit të standardit, për prirjet gjuhësore në regjistrin e ngritur, e të trashëguar etj. Kapitulli mbyllet me disa tekste popullore, temash të ndryshme, kryesisht me përbërës etnografikë, të cilat mbyllin kapitullin studimor për të folmet dhe hapin kapitullin e leksikut popullor e dialektor të kësaj treve.

Në kreun e dytë, në mbi 200 faqe të veprës është përfshirë korpusi i fjalësit të mbledhur në terren. Një pasuri e pamatshme e trashëgimisë sonë me interes për të gjithë fjalorët e përgjithshëm dhe të specializuar, fjalës për korpusin gjuhësor të shqipës, dhe fjali e shprehje frazeologjike për stilet gjuhësore e letrare të shqipës. Një numër i tyre gjendet edhe në fjalorët tjerë dialektor apo të përgjithshëm, por brenda tekstit që përdoret merr kuptim tjetër. Bie fjala, njësia leksikore *Abrash*, ~ i, m. merr vlera të tjera semantike: 1. Njeri që ecën ngadalë duke u tundur. Këmbët i heq shtrembër, sikur i heq zvarrë. Prandaj del me ngjyrim negativ, ndryshe nga kuptimi në Fjalor. *Ë, ...more abrash mezi tundesh.*

Prej një korpusi fjalësh si këto mund të krijohen fjalorth emrash të veshjeve popullore, bimëve, emra kafshësh e shpezësh, aktiviteteve popullore e artizanale, veglave të punës dhe mjeteve të jetës së përditshme. Fjala është për një listë prej:

a. Rreth dyqind emra bimësh dhe pjesësh të tyre: *Bëricë*, ~a, m., bot. Bimë barishtore që rritet zakonisht nëpër vreshta rreth 20-25 cm me gjethe të holla dhe të vogla. Ka një kërcell shumë të hollë dhe në majë lëshon lulen në formë furçe; *Bishtkali*, bot. Shih këputja. Bimë që rritet deri një metër. Ka kërcell të gjatë anash kërcellit dalin gjethe halore të buta. Kërcelli me gjethe ka formën e një tufe si bisht kali; *Bishtmushkë*, ~a, f.sh. ~ a, ~ at. bot. Bimë që rritet në vende me lagështirë me kërcell të bardhë e me gjethe si pishë. *Bishtmushkat* ishin rritur mjaft etj.

b. Rreth njëqind emra kafshësh dhe pijesh e veprimesh të tyre krahasuese: *Kacaqe*, ~ja, f.sh. ~et. Vithet e njeriut a të kafshës. *I hipi kalit në kacaqe*; *Këlit*, kal. ~a, ~ur. Ushqej me kujdes të voglin (për njerëzit dhe kafshët). *E këlita manarin me thërrime*; *Kërrma*, ~ja, f. 1. Misër i bluar trashë që përdoret si ushqim për kafshën.

c. Rreth dyzetë njësi leksikore për sëmundje të ndryshme: *Lavër*, ~a, f. Sëmundje që bie në bimë të ndryshme. Fasuleve dhe grurit u zverdh gjethet.

*U ra lavra fasuleve; Burdull,~i, m. Lloj sëmundjeje që u bie kafshëve. Pëla i ngordhi nga burdulli; Çalldëpsja, f. Sëmundje që prish fikun etj.*

**d.** Rreth njëqind e gjashtëdhjetë njësi për shtëpinë dhe punët rreth saj; Dajakos, *kal.~a,~ur. Mbjaj diçka me dajak që të mos bjerë. Ta dajakosim trarin e shtëpisë, pastaj ta prishim murin për ta rregulluar prapë; Dakike, ndajf. Erdha dakike në shtëpi. Erdha menjëherë në shtëpi etj.*

**e.** Rreth tetëdhjetë emra mjetesh e veglash të punës të jetës së përditshme: Krrësë,~a, f. Lloj vegle që shërben për të krehur e pastruar kafshët një a dy thundrake. *Më sill kresën sot se më duhet; Ondri,~a, f.sh.~et. Quhen veglat që përdor bujku si: parmenda, zgjedha... Merri ondriet e çoi tutje... etj.*

**f.** Rreth shtatëdhjetë emra rrobash, tekstilesh e veshjesh të ndryshme: All, alliri,~m. *sh. ~të. Qilim ose rrobë e vjetër që shtrohet poshtë një qilimi të mirë; Bello, mb. Vishem krejt me rroba të bardha. Ajo u bë bello. Ajo kishte veshur bluzë e fund të bardhë; Byrdele,~ja f.sh.~at. Rrobë që u vihet kafshëve të ngarkesës mbi vithe për ta mbrojtur nga të ftohtët etj.*

**g.** Rreth tetëdhjetë emërtime ushqimesh dhe përbërës të tjerë të lidhur me ushqimet: Gëzhutë~a, f.sh.~at. tërësia e ushqimit të një e disa thundrakëve; *Kacellë,~a, f. Arkë e madhe e bërë me dërrasa me kapak që hapet nga lart ku mbahen rrobat për fjetje ose ushqime, etj.*

**h.** Rreth njëzet emërtime të lidhura me bujqësinë: Kolistiri,~a, f. Vegël bujqësore, Çapë (shatë) për të prashitur; Bujqër,~i m. Dru i familjes ahore që përdoret si lëndë djegëse; *Kolistiri,~a, f. Vegël bujqësore, Çapë(shatë) për të prashitur; Liqer,~i, m.sh.~ë,~ët etj.*

**i.** Rreth njëzet emërtime të lidhura me kuzhinën: Blozë,~a, f.sh.~a,~at. Dhogë e gjerë e gjatë që vihej në mur që të mbaheshin enët e kuzhinës. Çdo mëngjes blozën e pastronte me pece; Çërnoke, *mb. Që janë të vjetra, të shtypura (përdoret për enë të çfarëdoshme kuzhine apo ujë) Avash se i bëre enët çërnoke; Hashef,~i, m.sh.~e,~et. Kuzhinë me oxhak; Kuckë,~a, f. Enë kuzhine e gjerë nga fundi e ngushtë lart, me dorezë, kapaku është i lidhur me trupin e enës etj.*

**j.** Mbi tridhjetë emërtime lojërash popullore: Mepat,~i, m. (s'ka shumë) Lojë që bënin gratë në dasmë. Një grua bëhej plakë, vishej me rroba të vjetra dhe mundohej të kapte fëmijët. Atë që kapte e mbante rob; Cige,~ja, f.sh.~et. Gropë e vogël, ku vendos shputën e këmbës gjatë lojës; Çalazi, *ndajf. Ecje me një këmbë. Një lojë duke ecur me një këmbë. Lozim çalazi etj.*

Pas sintezës shkencore të njërive frazeologjike, studiuesi ynë ka sjellë një korpus prej 300 njësish popullore, shumë prej të cilave me përbërës krahasues, logjik e semantik edhe me tërësinë frazeologjike të hapësirës shqiptare, një dëshmi kjo jo vetëm për homogjenitetin e leksikut të shqipes po edhe të semantikës e frazeologjisë së saj.

Në kreun e fundit, profesor Mërkuri sjell një fjalorth më vete të emërtimeve trashëguese të bimësisë. Megjithëse prej vitesh ai kishte botuar një vepër themeltare në këtë fushë, një sintezë shkencore, të cilën më parë e kishte botuar vetëm profesor Shefki Sejdiu, brenda këtij vëllimi sillet shumë më i plotë mbështetur në karakterin krahinor të të folmeve të Beratit me rrethinë.

Vepra *E folmja e Përmetit* përmbillet me një sintezë të të gjithë përbërësve dialektorë, fonetik e morfologjik. Autori i kësaj monografie, profesor Mërkuri arrin në përfundimet e tij se *E folma e Përmetit*, ka veçori dalluese nga të folmet e çamërishtes dhe labërishtes, dhe zë një pozicion të rëndësishëm ndër të folmet e toskërishtes së mirëfilltë. Karakteristikë e brendshme e saj konsiderohet ruajtja e mjaft tipareve arkaike.

Si e tillë, kjo vepër përmbush në mënyrë të ndjeshme atë përpjekjeje të shumë brezave të studiuesve prej rreth një shekulli për të hulumtuar e studiuar të gjitha të folmet e shqipes, në të gjitha krahinat etnografike shqiptare.

### 2.3. Fjalor onomastik i Përmetit

Dorëshkrimi *Fjalori i onomastik i Përmetit*, i profesor Nexhip Mërkurit, ndonëse nuk është vëllimi i parë i kërkimeve në fushë të toponimisë, megjithatë është njëri prej vëllimeve që është rezultat i një kërkimi të përkushtuar në terren dhe i një vëllimi të sistemuar brenda parimeve shkencore të fjalorëve të toponimisë në hapësirën shqiptare e të rajonit. Si i tillë, ky fjalor paraqet një pasuri të rëndësishme leksikore dhe mundësi të mira studimi, sinteze e krahasimi. Nëse në institucionet shkencore të Tiranës, toponimia në terren regjistrohej në sektorin e leksikut, në institucionet shkencore

të Prishtinës, toponimia regjistrokej, diskutohej e përfshihej si sektor më vete.

Vetëm gjatë dekadave të fundit të shekullit XX filluan të botohen vëllime të karakterit gjithëpërfshirës qoftë si kërkim i përmasave dialektore, qoftë si ndërmarrje e krahasueshme me leksikun, qoftë si botime të veçanta.

Sikur e kam theksuar më parë<sup>4</sup>, në gjysmën e parë të shekullit XX studimet për onomastikën shqiptare stabilizohen në të gjitha aspektet: në hulumtimin e përkushtuar, sipas shkollës antropogjeografike të kohës, në tipologjinë e saj sipas strukturës gjuhësore, në studimin e saj mbështetur në dokumentet e vjetra dhe madje me mendimin kritik që shfaqet për drejtshkrimin e saj, përdorimin e saj dhe sidomos me kërkesën për pastrimin prej trajtave të huaja dhe zëvendësimin e saj me struktura gjuhësore të shqipes.

Në hyrje të fjalorit të tij, profesor Nexhip Mërkuri ka sjellë pothuajse gjithë përvojën e vjelësve të mikrotoponimisë nga Kosova dhe Shqipëria. Për më tej vëllimi i mikrotoponimisë së Kosovës është pothuajse vetëm një shkrimje e tyre me mikrotoponiminë e Arkivit të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Sikur mund të shihet prej informacionit hyrës autori ynë për mbledhjen e mikrotoponimisë ka përdorur “Pyetësin për mbledhjen e toponimisë shqiptare” të prof. Mahir Domit e Gjovalin Shkurtajt, të cilin në fund të viteve '60 studiuesi i përkushtuar i mikrotoponimisë së Kosovës Skënder Gashi<sup>5</sup> e kishte përshtatur dhe botuar në Prishtinë për nevojat e punës në terren nga një brez mjaft i madh i studiuesve shqiptarë në ish-Jugosllavi.

Profesor Nexhip Mërkuri për realizimin e projektit të tij *Toponimia e Përmetit*, sikur e thotë në fjalën hyrëse ka realizuar rreth 110 ekspedita në terren. Le të kujtojmë këtu se autori i kësaj vepreje thellësisht të hulumtuar dhe gjerësisht të hapur në karakterin e

---

<sup>4</sup> Begzad Baliu, *Onomastika dhe dokumenti*, Prishtinë, 2013, f. 30-34.

<sup>5</sup> Skënder Gashi, *Si ta shënojmë toponiminë tonë*, në: “Përparimi”, nr. 11, Prishtinë, 1970, f. 591-594; Udhëzues i shkurtër mbi bazë të një udhëzuesi të Institutit të Gjuhësisë e të Historisë së Tiranës.

krijimit të korpusit të toponimisë, para se të realizonte këtë vëllim, po në këtë hapësirë etnografike të gjeografisë kombëtare, ka bërë kërkime edhe më parë për të realizuar projektet për emërtimin e bimëve dhe për studimin e të folmes së Përmetit.

Autori ynë etimologjinë e emrit të Përmetit e gjen te “*Parauej* plus Merop<*Përmet*, krijim i hershëm në gjuhën shqipe dhe si prirje për emërtime të tjera. Par+Me<dhe metateza fundore e bashkëtingëlloreve të shurdhëta p<t; a e patheksuar, e hapur evoluon në ë, gjysmë të mbyllur, dukuri e njohur për shumë fjalë në gjuhën shqipe dhe e ndërsjella, kur ngelet e patheksuar evoluon a<ë; <*Përmet*. Kjo mundësi krijimi është edhe për emërtime të tjera për zgjedhjen e kompleksit tingullor të bashkësisë dhe konceptit të fosilizuar”, përfundon profesor Mërkuri.

Të merresh me njësitë toponimike, ojkonimike, hidronimike, mikrotiponimike, patronimike, antroponimike e sidomos etnonimike të një fjalori si ky, pra, Fjalor i toponimisë së Përmetit, d.m.th të merresh me pasurinë materiale e shpirtërore të popullit e të trevës së kësaj ane, që është përfshirë në këtë korpus vlerash jo vetëm gjuhësore. Të merresh me anën tematike të toponimisë dhe patronimisë së këtij korpusi do të thotë të merresh me trashëgiminë historike të objekteve arkeologjike, fetare, natyrore në njërin anë dhe trashëgiminë popullore e mjetet e punës në anën tjetër; me objektet ekonomike që kanë siguruar sedentaritetin e popullatës së kësaj ane dhe me orientimet gjeografike që kanë përcaktuar komunikimin e saj me vendet, qytetet, tregjet, objektet detare, ekonomike, kulturore dhe sidomos bujqësore të kësaj popullate. Si të tilla ato janë të pasura nga aspekti gjuhësor e sidomos fjalëformues, shumëplanëshe nga aspekti semantik dhe komplementarë me gjuhët fqinje. Rrafshet e shumta gjuhësore: gjuhën shqipe mesjetare dhe të renë, sllavishten mesjetare, gjuhën greke, gjuhët orientale etj., e bëjnë këtë korpus mjaft të pasur e të diskutueshëm etimologjikisht dhe mjaft domethënës semantikisht.

Në vlerësimin tonë korpusit onomastik të këtij vëllimi po i qasemi duke bërë një tipologji historiko-gjuhësore, tematike, shumëgjuhësore etj.

1. *Toponimia ilire*: Në korpusin e mikrotoponimisë me përcaktor etnoniminë ilire, në radhë të parë të bie në sy shpjegimi i autorit për ojkonimin, përkatësisht fshatin *Kala*. “Thonë që emërtimi vjen ngaqë në fshat ka një kala të lashtë ilire. I përket krahinës së Malëshovës. Kufizohet nga lindja me fshatin Malëshovë, nga jugu me fshatin Leskaj dhe Limar, nga perëndimi me fshatrat e rrethit të Tepelenës, nga jugu me fshatrat e rrethit të Gjirokastrës. Emri i banorit: *kalasjot, kalsjote, sh. kalasjotë,~t, kalasjote,~t*”. Ajo që të bie në sy këtu është përcaktimi i provinencës ilire në këto emërtime. Në Kosovë bie fjala mikrotoponime të kësaj natyre regjistrohen me përcaktuesin *Vorret e rimit, Tumat e llatinit, Vorret e kreshnikve, Kalaja e rimit* etj.

2. *Ojkonimet dhe mikrotoponimet me emrin Kosovë*: Ajo që të bën përshtypje në këtë korpus është prania e emrit të Kosovës, i cili del edhe në anë të tjera të Shqipërisë Perëndimore, por dihet se fjala është për vendbanime të vona, kryesisht të gjysmës së parë të shekullit XX. Kosovë, arë. Fshati emërtohet Kosovë. Kështu është emërtuar edhe më parë. I përket krahinës së Cerjes. Kufizohet nga Veriu me Hotovën, nga Jugu me Lupckën, nga Lindja me fshatin Ogren, nga Perëndimi me fshatin Gosnisht. Emri i banorit: *kosovar, kosovarka, sh. kosovarë,~t, kosovarka,~t; Dolllokosovë, rrugë; Ndollokosovë, vend ku duket fshati Kosovë, Kosovare, arë e blerë nga një kosovar (fshat i Përmetit)* etj. Fakti se emri i Kosovës del si emër fshati, rrugë, arë dhe me trajta të tjera *Dollokosovë* e *Ndollokosovë*, të cilat nuk i gjejmë jo vetëm në Kosovë po as në anë të tjera të hapësirës shqiptare të bën të thellohesh edhe në rrafshe të tjera të këtyre emërtimeve dhe të zgjerosh referencat semantike të prejardhjes onomastike të emrit të Kosovës, shfaqur kryesisht në zonat sllave të Ballkanit dhe më tej Evropës Qendrore.

3. *Shembuj të traditës së hershme të shqipes*: *Umbalesh*, vend ku kanë pasur bagëti dhe kanë humbur gjithçka, (Rodenj); *Skarëni*, parcelë në buzë të lumit, s’ka rërë ose arë poshtë është vend

shkëmbor, më tej kalon Vjosa, (Kaludh); *Munushtir* (trajta e vjetër e shqipes për toponimin Manastir), *Leshnicë* (Lesh), *Fratar* (Frat) (Gërdas), Ubija (Ubla), arë, i krahasuar edhe me hidronimin e toponimisë shqipe *Ubla* në Mal të Zi. Profesor Çabej dhe sidomos profesor Ajeti këtë emërtim, që këtu del oronim, ndërsa në Mal të Zi, hidronim kanë dhënë vlerësime, interpretime e shpjegime të gjera. Po sjellim këtu vetëm një prej paraqitjeve të profesor Ajetit: “Me hetimet e hidronimit *Omblia*, që në mesjetë përdorej në forma të ndryshme dhe me vendthin *Bulentum* që gjendej në luginën përplot me gurra e kroje të ftohta te Dubrovniku, janë marrë shumë dijetarë: së pari për to bën fjalë historiani i mirënjohur i popujve të Ballkanit, Konstantin Jireček, në studimin e njohur të tij me titull: *Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien Während des Mittelalter*, Pragë, 1879<sup>6</sup>. Një tjetër mikrotoponim i trashëgimisë mesjetare që shfaqet dendur në gjithë hapësirën veriore të Shqipërisë është ojkonimi apo patronimi i sajuar nga dy përbërës emri+përbërësi i shqipes *lesh*. Ne po sjellim një shënim të Kordinianos (F. Cordignano, *Catasto veneto dl Scutari, 1416-17, 142*), të cilin e ka interpretuar dhe plotësuar profesor Ajeti: “Nga gjithë fshatrat që i përkasin Nahijes së Kuçit janë me siguri me origjinë shqiptare sa vijon: Pantalesh, Barzanj (Bardhanj), Bankeqi, Butidosi (Bytidosi). Emri i katunit Pantalesh është sajuar nga dy pjesë: nga përbërësja *Panta* dhe nga përbërësja shqipe *lesh*; përbërësen e dytë e gjejmë te emri i përveçëm Kambalesh „Nichola.Gambalessa” ose „Jon Cambalessi”,<sup>17</sup> ndërsa emri i katundit Barzanj (Bardhanj) është një krijim gjuhësor thjesht shqiptar, nga fjala shqipe *Bardh* (i bardhë) dhe prapashtesa (*a/nj*), toponim shumë i shpeshtë në truallin gjuhësor shqiptar<sup>7</sup>.

4. *Shembuj të etimologjisë vllehe*: Në mikrotoponiminë, e sidomos ojkoniminë dhe patroniminë e shqipes janë regjistruar një

<sup>6</sup> Shih, versionin serbokroatisht, të cilin e ka konsultuar profesor Ajeti: *Trgovački putevi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem vijeku*, od Dr Konstantina Jirečeka, Prag, 1879, *Zbornik Konstantina Jirečeka*, I, Beograd, 1959, str. 217-218.

<sup>7</sup> Shih *Studime për gjuhën shqipe* (Vepra të zgjedhura), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta XXIII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, libri 57. Zgjedhi dhe përgatiti, Akademik Rexhep Ismajli, Prishtinë, 2002, f. 638.

listë e gjerë emrash latino-romanë. Sikur është vënë re edhe nga studiues të tjerë në të gjithë trevat e Ballkanit, e kjo do të thotë edhe në Kosovë është dëshmuar disa herë se ka gjëlluar dhe ka krijuar edhe vendbanime një popullsi (arumune) baritore, duke lënë kështu edhe gjurmët e veta në fushë të makrotoponimisë. Në Kosovë përgjithësisht janë identifikuar ojkonimet dhe oronimet: *Beçuk* (Vushtrri), *Vllahi* (Mitrovicë), *Sibofc* (Obiliq), *Turiçec*, *Magure*, *Mikushnicë* (Skënderaj), *Magure* (Lipjan), *Llajshc* (Prishtinë), *Llukar* (Prishtinë), *Makresh* (Gjilan), *Magure* (Dragancë), *Rimanishtë* (Podujevë), etj. Në Fjalorin e profesor Mërkurit veç tjerash gjejmë mikrotoponimet: *Vllaho* – *Psilloterë*, *Përroi i Vllahut*, *përrua*, *Vllahinat*, arë; *Shpellë e Vllahut*, *shpellë* ku ka jetuar një vëlla (?) etj. Etimologjia e fundit lë për të diskutuar, sigurisht në një rast tjetër.

5. *Emërtime vendbanimesh të hershme*, që më shumë se vendbanime janë rrënoja dhe vendubifikimesh: *Qytezë*, vend me shenja të një kalaje ose manastiri, ka shenja të një qytetërimi; *Rrëke e Qytezës*, rrëke; *Grykë e Qytezës*, grykë në të cilën ndërtohej fshati më parë shumë i bukur, por i braktisur; *Burimi i Qytezës*, burim, *Bregu i Qytezës*, breg; *Shkëmbi i Qytezës*, shkëmb; *Guri i Qytezës*, gur; *Grykë e Qytezës*, grykë; *Qyteza*, korije; *Qytezë*, burim i qytezës, burim; *Qyteza*, arë. Le të thuhet në këtë rrjedhë se në toponiminë e hapësirës shqiptare vende të kësaj natyre, i gjejmë edhe me një sinonim tjetër të toponimisë me etimologji orientale: *Çardak*.

6. *Toponimi të provinencës latine: Fratar*, (fshat); *Rruga e Fratarit*, rrugë. Në regjistrat turke fshati përmendet me emrin Fratan. I përket krahinës së Dëshnicës. Kufizohet nga Veriu me fshatin Bënjë dhe Mërtinj, nga Jugu me fshatin Alipostivan, nga Lindja me fshatin Bejkollar, nga Perëndimi me fshatrat Kuqar dhe Riban. Fshati ka 34 familje e rreth 130 banorë.

7. *Shembuj të ndikimit kulturor grek: Këlcyrë*; e krahasuar me oronimin *Klisurë*, (Novo Bërd, Kosovë); *Shpella e Klisurës* (Istog), *Rruga e Dhromit*, rrugë, e krahasuar me emrin e rrugës *Udha e Drumit* (Marec, Kosovë); *Korije e Dhromit*; *Dhromi*, rrugë e shtruar me

kalldrëm, rrugë e lashtë që kalonin karvanet; *Dhromi i Vjetër*, rrugë e vjetër automobilistike, sot e braktisur; *Dhromë*, rrugë; *Dhromi*, arë etj.

8. *Shembuj të toponimisë sllave: Fshati Raban, Rrugë e Rabanit, rrugë; Rripë e Rabanit*, rripë e madhe etj. Sikur mund të shihet fjala është për trajtën mesjetare sllave të etnonimit Arban, një dëshmi e pranisë së popullatës sllave në këto anë, apo e ndikimit të kishës ortodokse bullgare. Etnonimi *raban* dhe ojkonimi gjithashtu është shënuar dhe diskutuar ndër dokumente të provinencës sllave e perëndimore (italiane), por nuk më ka rënë ta gjejmë të regjistruar këtë emërtim edhe në terren, prandaj si i tillë, në *Fjalorin onomastik të Përmetit*, paraqet një përbërës të një rëndësie të veçantë. Po këtu dalin edhe mikrotoponimet e hidronimet: *Grabovë, Sonovoda*, burim ku bën zhurmë uji që bie (Mokricë); *Podgoran* (Podgoran Fushë), *Zastenë*, shteg për të hyrë në pjesën e thepisur të malit Trebeshinë, në pjesën e Grykës; *Gropa e Serbinës*, gropë me ujë në mal, në P; *Bujgarët*, (Strëmbec), të cilët “erdhën nga Lëkurësi dhe u vendosën si bujq”, thuhet në shpjegimin e autorit. Fshatra të tilla me serbë nga Serbia dhe Hercegovina e Mali i Zi, madje jo vetëm të periudhës mesjetare po edhe të shekullit XX kemi edhe në Maqedoninë Perëndimore dhe në Kosovë.

9. *Toponimia e administratës dhe provinencës turke: Rruga e Sarajes, Lëmi i Beut, Hasandede, Luadhi i Beut, Sarajt, Gropë e Karajt, Sulltanet, Shelinoku i Vezirit, Këmbzë e Vezirit, Korije e Vezirit etj.*

10. *Toponimet - dëshmi e homogenitetit të toponimisë së gjeografisë kombëtare: Shën Mëria, çezmë; Shmria* (fshat në Kukës); *Zhervan*, vend me gurë të vegjël dhe i pjerrët dhe *Zheravinë* (Marec, Kosovë); *Varri i Italianëve*, varre ku janë varrosur italianët, dhe *Vorri Bugarit* (Makresh i Poshtëm, Kosovë); *Qafë e Sukës*, qafë, kullotë, dhe *Prroni Sukës* (Marec, Kosovë), *Karakolli Italian*, vend vrojtimi i ushtrisë italiane, dhe trajta turke e toponimet *Karakollat* (Verilindjes së Kosovës); *Havale e Grekut*, vend ku është vrrarë një grek etj.

11. *Mikrotoponimet me referencë simbolin kombëtar shqiponjën: Hije e Shkabit*, vend ku qëndrojnë shkabat; *Bregu i Shkabës*, vend ku rrinë shkabat; *Guri i Shkabës*, gur ku qëndrojnë shkabat; *Vrimë e*

*Shkabës*, vrimë ku bëjnë folenë shkabat; *Lisi i Shkabës*, pusi; *Havale e Shkabës*, vend ku qëndrojnë shkabat etj.

12. *Toponimia legjendare: Gropë e Alibeaj*, vend gropë e fundosur sipas legjendës pasi beu mori Vajzën grua; *Arë e Çupës*, arë, sipas legjendës për çupën; *Arë e Kamës*, arë, sipas legjendës, vend tek i cili u takuan dy palë krushq, nusët u panë me njëra-tjetrën. Shembuj të tillë kemi regjistruar edhe në Kosovë gjithandej, por me shpjegime pak a shumë të ndryshme.

Korpusi i *Fjalorit të onomastikës së Përmetit* paraqet kontribut të vyer në studimet onomastike të shqipes, për disa arsye: e para, sepse ai është dokument i munguar oral dhe i gjallë i pjesës qendrore të Shqipërisë Juglindore.

Me këtë vëllim të vjelë nga terreni dhe të regjistruar me kujdes, përkatësisht nga qyteti i Përmetit me rrethinë, profesor Mërkuri sjellë elemente të reja në korpusin jo shumë të pasur të toponimisë shqiptare. Ky korpus gjuhësor dëshmon për homogjenitetin e toponimisë së gjeografisë kombëtare. Shumë nga këto mikrotoponime kanë ruajtur trajta gjuhësore të shuara të shqipes antike e mesjetare, të krahasueshme me dokumente të shkruara të kohës nga provinienca latine, sllave dhe greke. Si i tillë vëllimi *Fjalor i onomastikës së Përmetit*, do të jetë një ndihmesë e pakrahasueshme dhe e pazëvendësueshme për korpusin gjithëkombëtar të *Fjalorit të onomastikës shqiptare*.

## **Përfundime**

Profesor Nexhip Mërkuri është njëri prej studiuesve të brezit më të dytë që ka krijuar shkolla shqiptare e viteve '90 e këndej. Ashtu si edhe pjesa më e madhe e studiuesve të brezit të tij, që vinin nga qendrat Universitare të rretheve: Ali Jashari (Korçë), Valter Memisha (Gjirokastër), Petrit Kotrri (Shkodër) etj., fillimisht provoi përgjegjësinë e të qenit mësime në qytetet dhe shkollat e zonave anësore. Profesor Mërkuri kësaj zeje madje nuk ju nda deri në fund, në shkallët e Universitetit të Vlorës, duke u bërë gjithashtu njëri

prej bartësve të mendimit didaktik në mësimdhënien e këtij shekulli. Me mendimin teoriko-pedagogjik të mësimdhënies, me tekstet didaktike të shkollave fillore dhe të mesme, me punën prej edukatori në shkolla dhe në universitet, si dhe me diskutimet e tij për sillabusët e gjuhës shqipe, profesor Mërkuri e ka përmbushur shumanshëm portretin e tij prej edukatori.

Kërkimet e tij shkencore profesor Mërkuri i ka filluar në rrethana të një shoqërie në tranzicion, duke marrë nga ajo që ka trashëguar në sinorin kombëtar të gjuhësisë dhe duke vjelë arritjet më të mira të gjuhësisë bashkëkohore. I përkushtuar në kërkimet e zonës së tij të lindjes e të punës prej mësimdhënësi në Përmetit me rrethinë, ai nuk pushoi së kërkuari në terren gjithë pasurinë leksikore e frazeologjike.

Kërkimet shkencore të tij si asnjë studiues i kësaj natyre në fushë të gjuhësisë ai i ka hulumtuar e studiuar në disa rrafshë: në rrafshin leksikor, semantik e frazeologjik; në rrafshin dialektologjik (fonetik, morfologjik, sintaksor e tekstor); si dhe në rrafshin onomastik (antroponimik e toponimik). Përmasa e kërkimeve të tij shkon nga tekstet deskriptive e studimet e thelluara shkencore te monografitë e specializuara e *Fjalorët*. Nëse studimet janë kryesisht projekte të interesimeve të tij shkencore edhe për paraqitje në konferenca shkencore dhe botime në revista akademike, monografitë e tij përfaqësojnë sinteza të një përvoje të tij të gjatë në kërkimet shkencore në projekte të përmasave kombëtare. Nuk është e rastit që studimet e tij teoriko-gjuhësore, historiko-gjuhësore e krahasuese, ai i ka përfshirë në vëllime të veçanta, ndërsa sintezat e specializuara në monografi të fushave përkatëse.

Le të thuhet më në fund se profesor Nexhip Mërkuri, me jetën dhe me veprën, me përkushtimin prej edukatori e prej hulumtuesi, me veprën didaktike dhe me veprën shkencore, gjatë një gjysmëshekulli pune në institucionet shkollore e akademike dhe në tryezën e tij shkencore, e ka përmbushur gjithanshëm portretin e tij prej edukatori e shkencëtari.

## Literatura

Ajeti, Idriz, *Studime për gjuhën shqipe* (Vepra të zgjedhura), Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2022.

Baliu, Begzad, *Onomastika dhe dokumenti*, Prishtinë, 2013.

Gashi, Skënder, *Si ta shënojmë toponiminë tonë*, në: “Përparimi”, nr. 11, Prishtinë, 1970.

Jirečeka, Konstantin, *Trgovački putevi i rudnici Srbije i Bosne u srednjem vijeku*, in (*Zbornik Konstantina Jirečeka, 1879*), Beograd, 1959.

Mërkuri, Nexhip, *E folmja e Përmetit (Fjalor krahinor, fjalori i bimësisë së trashëguar)*, Vlorë, 2009.

Mërkuri, Nexhip, *Fjalori i onomastik i Përmetit*, Tiranë, 2024.

Mërkuri, Nexhip, *Gjuhësi e krahasuar*, Vlorë, 2018.

Mërkuri, Nexhip, *Kërkime etnolinguistike tek emërtimet e bimësisë*, Vlorë, 2003.

Mërkuri, Nexhip, *Onomastikë krahasuese*, Vlorë, 2022.

## PROFESSOR NEXHIP MËRKURI: THE LINGUIST AND THE EDUCATOR

### Summary

Professor Nexhip Mërkuri is one of the researchers of the second generation who created the Albanian school from the 90s onwards. Like most of the researchers of his generation, who came from the University centers of the districts: Ali Jashari (Korçë), Valter Memushaj (Gjirokastër), Petrit Kotrri (Shkodër), etc., he first tried the responsibility of being a teacher in outlying towns and schools. Professor Mërkuri did not even part with this craft until the end, on the steps of the University of Vlora, also becoming one of the bearers of didactic thought in the teaching of this century. With the theoretical-pedagogical thinking of teaching, with the didactic texts of primary and secondary schools, with the work of the educator in schools and universities, as well as with his discussions about the syllabuses of the Albanian language, professor Mërkuri has fulfilled his portrait in many ways. the educator.

Professor Mërkuri has started his scientific research in the circumstances of a society in transition, taking from what he has inherited in the national field of linguistics and reaping the best achievements of contemporary linguistics. Devoted to the research of his birthplace and work area as a teacher in Përmet and its surroundings, he did not stop looking for all the lexical and phraseological wealth in the field.

He has researched and studied his scientific research like no other researcher of this nature in the field of linguistics in several levels: in the lexical, semantic and phraseological level; on the dialectological level (phonetic, morphological, syntactic and textual); as well as on the onomastic level (anthroponymic and toponymic). The extent of his research ranges from descriptive texts and in-depth scientific studies to specialized monographs and dictionaries. If the studies are mainly projects of his scientific interests for presentation

at scientific conferences and publications in academic journals, his monographs represent syntheses of his long experience in scientific research in projects of national proportions. It is no coincidence that he included his theoretical-linguistic, historical-linguistic and comparative studies in separate volumes, while specialized syntheses in monographs of the respective fields.

Finally, let it be said that Professor Nexhip Mërkuri, with his life and work, with his dedication as an educator and researcher, with his didactic work and with his scientific work, during half a century of work in educational and academic institutions and at his scientific desk, has comprehensively fulfilled his portrait of educator and scientist.